



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2750/15 prot.

Datë 26.01.2024

V E N D I M

Nr. 94/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.01.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK dhe operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group Sh.A, OSSH Sh.A, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit” me fond limit 59,032,679.90 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 29.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e sipërcituar të prokurimit.

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group Sh.A, OSSH Sh.A, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit” me fond limit 59,032,679.90 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 29.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.

- Ankimues:** Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK, me NIPT K21605003M dhe adresë: autostrada Tiranë - Durrës, rruga dytësore, km 9, god 3- katëshe, Tiranë.
- Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë.
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, me NIPT L91418502J, dhe adresë: Durrës, Zona Kadastrale Nr. 8517, e llojit truall plus ndërtesë 4 kate, me sipërfaqe trualli 1000 m2 dhe sipërfaqe ndërtesë 330 m2, Durrës, Spitalë.
- Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q, dhe adresë: autostrada Tiranë - Durrës, Km 8, Kodër Kashar, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në

përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. . Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.08.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group Sh.A, OSSH Sh.A, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit” me fond limit 59,032,679.90 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 29.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.

II.2. Në datën 29.09.2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 19.10.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “LIBRARI DYRRAHU” ShPK	29,000,000 lekë	kualifikuar
2. “Infosoft Office” ShPK	33,781,117 lekë	kualifikuar
3. “Interlogistic” ShPK	52,074,014 lekë	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimit elektronik, më datë 30.10.2023, rezulton se është publikuar në SPE, Njoftimi i Fituesit Paraparak.

II.5. Në datën 08.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3575 dhe me nr. 2750/2023 prot., datë 08.11.2023 e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK. Nga shqyrtimi paraparak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “Librari Dyrrahu” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2750/2 prot., datë 09.11.2023.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezultoi, se operatori ekonomik i interesuar “Librari Dyrrahu” SHPK **nuk ka** dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

II.8. Me shkresën nr. 6413/16 prot., datë 23.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2750/3 prot., datë 30.11.2023, me objekt “Dërgim dokumentacioni”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezultoi, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës për pretendimet e ngritura nga ankimuesi për operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK dhe mospranimin e ankesës për pretendimet e ngritura nga ankimuesi për operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK konkretisht duke argumentuar: “[...] Bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” autoriteti kontraktor vendosi të marr në shqyrtim ankesën me nr. 2750/2023 Prot., datë 08.11.2023 (paraqitur ne portalin online) në të cilën nga ana Juaj pretendohet se nuk përmbushen kriteret nga operatori ekonomik i renditur i pari në këtë procedurë, “Librari Dyrrahu” sh.p.k.

Pretendimet Tuaja qëndrojnë pjesërisht dhe arsyetimin po jua paraqesim më poshtë:

1-Përsa i përket pikës së parë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit: - “Librari Dyrrahu” SHPK nuk ka mbushur në mënyrë të saktë formularin e përcaktuar në shtojcën 8 KSHA pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur sqaron se shtojca 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” është plotësuar sakte sipas formatit të ri me ndryshimet dhe shtesat përkatëse.

Për sa shpjeguar më lart pretendimi i ankuesit nuk qëndron.

2-Përsa i përket pikës së dytë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit:

- Në dokumentet Standarde të Tenderit në pikën 2.4.4 dhe 2.4.5 parashikohet si më poshtë vijon: “2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar ku ne çdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike të prodhuesit ose ekuivalente. Kjo skede të jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të jete të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij për produktin letër A4” 2.4.5 Me qellim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë mostra për letër Ad nje rizem. Mosdorezimi i mostres se kerkuar perben shkak per skualifikim”. Gjithashtu, në dokumentet standarde të tenderit “Formulari i specifikimeve teknike ” është kërkuar: Artikulli nr. 1 letër A4 me specifikime teknike “Format A4, jo me pak se 78 grim2 sipas ISO 536, paketuar ne rizma 500 flete. 1 risem me peshe jo me te vogel 2500 gr ne peshore elektronike, Bardhesia CIE sipas ISO

11475 jo me pak se 145, me Opacitet > 92% sipas ISO 2471, Ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470, Trashësia 100-115 sipas ISO 534, Ashpërsia 80 — 180 ml/min sipas ISO 8791 si dhe Rezistenca në përthyerje MD (mN) >100 sipas ISO 2493, Rezistenca në përthyerje CD (mN) > 45 sipas ISO 2493. (Double A ose Ekuivalent)” Ditën e hapjes së procedurës, përfaqësuesit e kompanisë tonë kanë konstatuar se ofertuesi, Librari Dyrrahu ShPK, ka dorëzuar si moster të artikullit letër, Markën COPY 1. Kompania jonë Interlogistic ShPK është tregtar prej shumë vitesh gjithashtu i letrës COPY 1 dhe disponojmë skeden teknike të COPY 1, ku skeda teknike e kësaj marke nuk përmbush të gjithë parametrat e kërkuar në DST nga ana e autoritetit kontraktor dhe si e tillë duke qenë se nuk përmbush kriterin “2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar ku ne cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike të prodhuesit ose ekuivalente. Kjo skedë të jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të jene të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij për produktin leter A4”, ofertuesi duhet të ishte skualifikuar nga procedura e prokurimit. Në lidhje me skedën teknike të COPY 1, vihet re se mungojnë parametrat Rezistenca në përthyerje MD (mN) > 100 sipas ISO 2493, Rezistenca në përthyerje CD (mN) > 45 sipas ISO 2493. Nga sa më sipër konstatuam, në lidhje me të gjitha mangësitë e konstatuara ofertuesi duhet të ishte skualifikuar nga procedura e prokurimit.

Sqarojme se KSHA nga verifikimi i skedes teknike të paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” sh.p.k ka verifikuar që nuk ka të dhena për specifikimet teknike të kerkuara – Rezistenca në përthyerje MD (mN) >100 sipas ISO 2493, Rezistenca në përthyerje CD (mN) > 45 sipas ISO 2493.

Gjithashtu, KSHA marrë shkas nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” ShPK dhe nga ankesa juaj, ju drejtua zyrtarisht me email – xxxxxxxxxxxxxxxx me qellim verifikimi dhe kerkoi informacion kush është distributori zyrtar për Letren Fabiano — Copy 1 në Shqipëri.

Ne kthim pergjigjen e dates 19.11.2023 Fabiano, konfirmon se distributor zyrtar për të gjitha brandet e letres Fabiano është Infosoft.

Ne keto kushte KSHA e gjeti të sakte konstatimin Tuaj dhe ka vendosur ta pranojë ankesën për këtë pike.

Pretendohet nga ana Juaj se operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k nuk ka paraqitur skedën teknike të prodhuesit (ose ekuivalente), skedë teknike e cila duhet të jetë e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij për produktin leter A4.

Pra sa më sipër pretendimi Juaj qëndron.

3-Përsa i përket pikes së tretë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit’’: - Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” sh.p.k, ka paraqitur një ofertë ekonomike tërësisht anomalisht të ulët. Fondi limit i përcaktuar në DST për këtë procedurë prokurimi është 59,032,679.90 (pesëdhjetë e nëntë milion e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë) leke pa TVSH dhe oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” është në vlerën e 29 000 000 (njëzet e nëntë milion) Lekë pa TYSH. Thënë ndryshe kjo ofertë është 49% (dyzet e nëntë përqind) më e ulët se vlera e fondit limit. Në zbatim të nenit 93, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, dhe nenit 82, pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, duke iu referuar procedurës prokuruese të lartpërmendur, kjo ofertë do të duhet të konsiderohet i) anomalisht e ulët, dhe si rrjedhojë të konsiderohet ii) e papranueshme nga AK. Më poshtë Ju parashtrojmë në mënyrë të detajuar se ky operator ekonomik, bazuar në çmimet për njësi të ofertuara, dhe vlerës totale të ofertuar nuk arrin të realizojë pjesën dërrmuese të artikujve mallrave të kërkuara nga DST për këtë procedurë të prokurimit publik... KSHA ka bere rivleresimin e argumentimit te ofertes anomalisht te ulet, te dorezuar me shkresen me nr. 8051 prot., date 16.10.2023 dhe ne perfundim ka arritur ne konkluzion se argumentimi i ofertes nuk eshte bere konform kerkesave te nenit 93, pasi nuk jane argumentuar te gjithë elementet e kerkuar, me konkretisht:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit,
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhelose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës:
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi,
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës:
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Pra sa më sipër pretendimi Juaj qëndron.

Në përfundim, për gjithçka sa trajtuam më lart, pretendimet Tuaja qëndrojnë pjesërisht ndaj ne përfundim KSHA ka vendosur ta refuzojë ofertën e paraqitur nga “Librari Dyrrahu” sh.p.k si jo të përgjegjshme.

II-Bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” autoriteti kontraktor vendosi të marr në shqyrtim ankesën me nr. 2750/2023 Prot., datë 08.11.2023 (paraqitur në portalin online) në të cilën nga ana Juaj pretendohet se nuk përmbushen kriteret nga operatori ekonomik i renditur i dyti në këtë procedurë, “InfoSoft Office” sh.p.k.

Pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë dhe arsyetimin po jua paraqesim më poshtë:

1-Përsa i përket pikës së parë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit: - Në lidhje me shtojcën e mësipërme pretendojmë që ofertuesi InfoSoft Office, nuk ka mbushur në mënyrë të saktë formularin e përcaktuar në shtojcën 8, duke mos deklaruar saktë aksioneret e tij më saktë Dobi Management. Pretendimin e mësipërm e mbështesim në faktin që Agjencia e Prokurimit Publik me anë të njoftimit nr. 6776 datë 05.10.2.2022 me lëndë “Autoriteteve/Enteve, Operatorëve ekonomike”, njofton të gjitha subjektet e interesuara të cilat meren me prokurime, se ka miratuar disa ndryshime shtesa në setet e DST për mallra, punë, shërbime. Në bazë të njoftimit të lartpërmendur, APP ka bërë disa ndryshime në DST konkretisht në shtojcën 8 duke pasqyruar ndryshimet të cilat nëse nuk mbahen parasysht nga ana e operatorëve ekonomike ofertues, detyrojnë autoritetet entet kontraktore në skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit. Sa më sipër pretendojmë që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka kontrolluar në mënyrë të saktë shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” (sipas ndryshimeve) të paraqitur në sistemin elektronik të APP-së nga ana e ofertuesit InfoSoft Office duke skualifikuar atë.

KSHA ka bere verifikimin e shtojces 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” te paraqitur nga ofertuesi “InfoSoft Office” dhe ka vleresuar se eshte plotesuar sakte sipas formatit te ri me ndryshimet dhe shtesat perkatese.

Pra sa më sipër pretendimi Juaj nuk qëndron.

2-Përsa i përket pikës së dytë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit: - Në dokumentet Standarde të Tenderit në pikën 2.4.4 dhe 2.4.5 parashikohet si më poshtë vijon: “2.4.4 Operatori ekonomik duhet te paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike te prodhuesit ose ekuivalente. Kjo skede te jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku te jene te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike te tij per produktin leter A4” 2.4.5 Me qellim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë mostra për letër A4 nje rizem. Mosdorezimi i mostres se kerkuar perben shkak per skualifikim”. Gjithashtu në dokumentet standarde të tenderit “Formulari i specifikimeve teknike” është kërkuar: Artikulli nr. 1 letër A4 me specifikime teknike “Format A4, jo me pak se 78 gr/m2 sipas ISO 536, paketuar ne rizma 500 flete. 1 risem me peshe jo me te vogel 2500 gr ne peshore elektronike, Bardhesia CIE sipas ISO 11475 jo me pak se 145, me Opacitet >92% sipas ISO 2471, Ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470, Trashësia 100-115 sipas ISO 534, Ashpërsia 80 — 180 m/min sipas ISO 8791 si dhe Rezistenca në përthyerje MD (mN) - 100 sipas ISO 2493, Rezistenca në përthyerje CD (mN) 2 45 sipas ISO 2493. (Double A ose Ekuivalent)” Ditën e hapjes së procedurës, përfaqësuesit e kompanisë tonë kanë konstatuar se ofertuesi, Infosoft Office shpk, ka dorëzuar si moster të artikullit letër, Markën Navigator. Nga lundrimi në faqen zyrtare të prodhuesit të Navigator, konstatuam se skeda teknike kësaj marke nuk përmbush të gjithë parametrat e kërkuar në DST nga ana e autoritetit kontraktorë dhe si e tillë duke qënë se nuk përmbush kriterin “2.4.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike te prodhuesit ose ekuivalente. Kjo skede te jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku te jene te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike te tij per produktin leter A4”, ofertuesi duhet të ishte skualifikuar nga procedura e prokurimit. Ne si kompani pretendojmë që marka Navigator e dorëzuar nga ofertuesi Infosoft Office shpk, nuk është sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DST. Ne duam që të gjithë operatorët të krahasohen me të njëjtin standard letre dhe të njëjtat parametra të kërkuara në DST, prandaj kërkojme që kjo moster të permbushi specifikimet teknike të kerkuara. Në Dokumentet Standarde të Tenderit, të publikuara nga autoriteti kontraktorë, artikulli Letër Ad përbën mbi 80% të produkteve të kërkuara në vlerë dhe volum, nga ana e autoritetit dhe mungesa e elementëve të sipërcituar për këtë artikull përbën një kercenim serioz që në magazinat e autoritetit të vijë një mall jo i duhur dhe jo konform specifikimeve teknike duke i shkaktuar në këtë mënyrë një dëm ekonomik buxhetit të shtetit.

Nga kontrolli i dokumentacionit te paraqitur ne SPE nga ana e shoqerise ofertuese Infosoft Office ShPK ne permbushje te kesaj pike, rezulton qe eshte paraqitur ne formen e kerkuar autorizimi i prodhuesit te letren me te cilen ka ofertuar, si dhe skeda teknike e certifikuar nga distributori i autorizuar, ku jane te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike per produktin leter A4. Referuar specifikimeve teknike te pasqyruara ne skede teknike rezulton se

letra me te cilen ka ofertuar subjekti Infosoft Office ShPK ploteson te gjitha specifikimet teknike te kerkuara ne dokumente tenderi.

Pra sa më sipër pretendimi Juaj nuk qëndron.

Në përfundim për gjithcka sa trajtuam më lart, pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë ndaj ne përfundim KSHA ka vendosur ta refuzojë ankesën lidhur me subjekti “Infosoft Office” ShPK.”

II.9. Me shkresën e datës 07.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 2750/4 prot., datë 12.12.2023, me lëndë “Kërkesë për marrjen në shqyrtim të një prove të re lidhur me shqyrtimin e ankesës me numër protkollu nr. 2750 prot., lidhur me procedurën me numër reference REF-78398-08-28-2023, Procedurë e Hapur-Mallra-Mbi kufirin e lartë monetar, me autoritet kontraktor OSHEE Group sh.a” “Librari Dyrrahu”SHPK ka paraqitur në KPP informacion shtesë, duke kërkuar rivlerësimin e vendimit të bërë nga autoriteti kontraktor dhe rikualifikimin e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu”SHPK konkretisht duke argumentuar: “Nga ana Juaj po shqyrtohet ankesa me numër protokollu nr. 2750 prot., lidhur me procedurën me numër reference REF-78398-08-28-2023, Procedurë e Hapur — Mallra - Mbi kufirin e lartë monetar, me autoritet kontraktor OSHEE Group ShA. Jemi njohur me një fakt të ri dhe çmujmë të arsyeshme dhe të domosdoshme shqyrtimin nga ana Juaj, duke qënë se akoma nuk keni një vendimmarrje. Bazuar ne nenin 47 të Kodi të Pr. Administrative parashikohet e drejta e të gjitha palëve, në çdo fazë të procedurës, të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes. Autoriteti Kontraktor kur na ka vënë në dispozicion vendimin e tij lidhur me ankimin e paraqitur për procedurën si më sipër cituar, jemi njohur me faktin se i është drejtuar kompanisë Fabiano, pjesë e grupit Fedrigoni, duke e pyetur se cili është distributori i autorizuar për letrën Fabiano Papers — Copy 1 në Shqipëri.

E-mail dërguar nga Autoriteti Kontraktor:

Da: G.M xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx

Inviato: sabato 18 novembre 2023 15:50

A: P.P [xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx](#)

Cc: xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx

Oggetto: Request for Information

Dear Madam/Sir,

Hope you are fine. We are contacting you from OSHEE Group Albania.

Referring an ongoing procurement procedure in our company, we would like to get an information from you to clarify and asses our evaluation on the procurement procedure participants. Specifically, we would like to be informed for: “Who is the official distributor for Fabiano Papers — Copy 1 in Albania“

We will appreciate a quick feedback.

Thank you in advance.

Kind regards.

Këtë pyetje të AK e shikojmë tendencioze dhe keqdashëse. Autoriteti dispononte një autorizim të vënë në dispozicion nga ana jonë dhe këtë autorizim në funksion të hetimit që po përpiqej të kryente duhet t'ia vinte në dispozicion kompanisë Fabriano, pasi siç shihet në një korrespondencë të mëparshme, kjo e fundit pranon faktin se ka qenë e nxituar në përgjigjen e saj pasi ndërkohë ka autorizuar dhe OE Librari Dyrrahu për të marrë pjesë në tender me të njëjtin produkt letre.

P. P

To: [xxxxxxx](#)

Cc: [xxxxxxxxxxxx](#); xxxxxxxx

Dear all,

I probably replied too hastily to the email below.

I confirm that our distributor in Albania is Infsoft but we have actually authorized the company Librari Dyrrahu to participate in your tender with our Copy 1 and Extra Laser papers, as a function of direct collaboration with this Company we are starting.

Therefore I confirm that Librari Dyrrahu is indeed authorized by us.

For any further info don't hesitate to contact me,

Pra, të nderuar jemi të bindur se AK nuk ka dashur të bëjë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm por ka abuzuar me kërkimin e informacionit.

Sjellim në vëmendje se në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik si dhe të kërkojë informacion shtesë lidhur me paqartësi të hasura, për një gjykim sa më të drejtë dhe transparent të vlerësimit.

Shqyrtimi i ankimit administrativ është një mjet me karakter verifikues dhe vërtetues të pretendimeve të ngritura. Autoriteti Kontraktor në rastin konkret duhet domosdoshmërisht, në bazë të parimeve administrative të kishte bërë një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Rezulton se AK nuk ka kryer një hetim të plotë dhe marrjen në shqyrtim të të gjithë dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi.

Ky veprim i AK, ka çuar në refuzimin e një oferte tepër ekonomike dhe automatikisht renditjen në radhë të një oferte tjetër më të shtrenjtë. Fakt ky që bie në kundërshtim me një ndër qëllimet e LPP, neni 1 ku përcakton se një ndër qëllimet e këtij ligji është të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike. Për më tepër në kundërshtim edhe me LPP, neni 3, ku parashikon se autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllim për të favorizuar apo dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 16272020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj

ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Për sa më sipër rezulton e provuar se autorizimi për artikullin letër është lëshuar në njërin prej formave të përcaktuara në kriterin kualifikues të sipërpërmendur dhe konkretisht nga prodhuesi. Arsye për të cilën dokumentacioni i dorëzuar nga ana jonë e ka plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik theksojnë se tre ndër qëllimet kryesore të ligjit të prokurimit publik janë ato të nxitjes së konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik si edhe sigurimin e integritetit, besimin e publikut dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

Neni 12 i Kodi të Pr.Administrative parashikon parimin e proporcionalitetit i cili sanksionon se: 1. Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2. Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është: a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që cenojnë më pak të drejtat apo interesat legjitimë të palës: b) i përshatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj, dhe c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Në nenin 4 të Kodit të Pr. Administrative sanksionohet parimi i ligjshmërisë, Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. 2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ përveçse kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.

Për të gjithë argumentet e dhëna më sipër gjykojmë se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një vlerësim objektiv dhe të paanshëm mbi bazën vetëm të kriterëve për kualifikim të vendosura në DST dhe ligjit. Duke qenë se kemi përmbushur të gjitha kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të vendosura nga autoriteti kontraktor në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik” i ndryshuar, kërkojmë nga ju rivlerësimin e vendimit të bërë nga AK dhe rikualifikimin e Operatorit Ekonomik Librari Dyrrahu SHPK.”

II.10. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, KPP konstaton, se për sqarimin e fakteve dhe pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues për operatorin ekonomik “Infosoft Office” SHPK, të papranuara nga autoriteti kontraktor, konkretisht në lidhje me specifikimet teknike të mostrës, kërkohen njohuri të posaçme teknike nga laboratorë të specializuar për kryerjen e testimit të letrës A4. Prandaj KPP, për një gjykim të drejtë dhe transparent të ankesës, vlerësoi të kryhej veprimi procedural i testimit të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në përputhje me specifikimet teknike, referuar pretendimeve të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK, me qëllim asistimin e Komisionit të Prokurimit Publik, për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues. Për këtë bashkë me njoftimin e palëve për

paraqitjen në seancë dëgjimore pranë KPP lidhur me testimin e mostës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, iu kërkua autoritetit kontraktor dhe paraqitja e mostrës së letrës A4, të dorëzuar nga ky operator pranë autoritetit kontraktor.

II.11. Në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 641/11 prot., datë 04.05.2022, me objekt: “Kërkesë për informacion”, me shkresën nr. 185/1 prot., datë 09.05.2022, Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon se: “[...] laboratori i vetëm i akredituar prej saj për testimin e letrës dhe kartonit është Eko-Studio Projekt SHPK me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nr.48, Tiranë”

II.12. Në datën 25.01.2023, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2710/8 prot., shkresa e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, me nr. 47 prot., datë 23.01.2023, me objekt: “Kthim - përgjigje shkresës me nr. 2710/7 prot., datë 17.01.2023”. Me anë të kësaj shkrese bëhet me dije se:

“[...] Eko Studio Projekt SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve ndër të tjerë dhe të [...] letrës dhe kartonit.”

Për kryerjen e matjeve laboratorike Eko – Studio –Projekt është e pajisur me Certifikatë Akreditimi me numër Regjistrimi LT 070, konform standardit S SH ISO/IEC 17025:2017, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me ligjin Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim tabela me standardet e provës dhe të mostrimit dhe sqarimin se:

<i>Letër – Karton – Brumë Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi Provës</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standardi Provës</i>	<i>Standardi Mostrimit</i>
1.	<i>Densiteti</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
2.	<i>Gramatuara</i>	<i>0g-120g 0g-2000g</i>	<i>SSH ISO 536:2020</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
3.	<i>Trashësia</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
4.	<i>Volum Specifik</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>

“Kryejmë edhe testim dhe matje të komponentëve të letrës dhe kartonit sipas standardeve të përcaktuara në vijim:

<i>Letër – Karton – Brumë Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi Provës</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standardi Provës</i>	<i>Standardi Mostrimit</i>
1.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-3000</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>

		<i>ml/min</i>		
2.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-5000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
3.	<i>Bardhësia</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 11475:2017 ISO 2470-1:2016</i>	<i>ISO 186:2002</i>
4.	<i>Faktori i shpërndarjes së ndriçimit</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 2469:2007</i>	<i>ISO 186:2002</i>
5.	<i>Tejdukshmëria</i>	<i>CIE illuminant C</i>	<i>SSH ISO 2471-1:2008</i>	<i>ISO 186:2002</i>
6.	<i>Mbetje hirit</i>	<i>0.2% - 100 %</i>	<i>SSH ISO 2144:2019</i>	<i>ISO 186:2002</i>
7.	<i>pH</i>	<i>4-10</i>	<i>SSH ISO 6588-1:2021</i>	<i>ISO 186:2002</i>
8.	<i>Alkalinitetit</i>	<i>0.07-2 mol/kg CaCO₃</i>	<i>SSH ISO 10716:2022</i>	<i>ISO 186:2002</i>

“Për kryerjen e testimeve dhe fiksimit të rezultateve duhet të dërgohen në ambientet e laboratorit kampione përfaqësues në mjediset e laboratorit.

<i>Nr.</i>	<i>Shërbim</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Cmimi në lek pa TVSH</i>
1.	<i>Analiza gramaturës</i>	<i>Copë/një testim</i>	1	6600

II.13. Gjithashtu, në datën 06.02.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2710/9 prot., shkresa e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK me nr. 47/2 prot., datë 23.01.2023 me objekt: “Kthim - përgjigje shkresës me nr. 2710/7 prot., datë 17.01.2023”. Me anë të kësaj shkrese bëhet me dije se:

“[...] Eko Studio Projekt SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve ndër të tjerë dhe të [...] letrës dhe kartonit.”

Për kryerjen e matjeve laboratorike Eko – Studio –Projekt është e pajisur me Certifikatë Akreditimi me numër Regjistrimi LT 070, konform standardit S SH ISO/IEC 17025:2017, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me ligjin Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim tabela me standardet e provës dhe të mostrimit dhe sqarimin se:

<i>Letër – Karton – Brumë Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi Provës</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standardi Provës</i>	<i>Standardi Mostrimit</i>
1.	<i>Densiteti</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
2.	<i>Gramatuara</i>	<i>0g-120g 0g-2000g</i>	<i>SSH ISO 536:2020</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
3.	<i>Trashësia</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>

4.	<i>Volum Specifik</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
----	-----------------------	-----------------------	----------------------------	----------------------------

“Kryejmë edhe testim dhe matje të komponentëve të letrës dhe kartonit sipas standardeve të përcaktuara në vijim:

<i>Letër – Karton – Brumë Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi Provës</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standardi Provës</i>	<i>Standardi Mostrimit</i>
1.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-3000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
2.	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-5000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
3.	<i>Bardhësia</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 11475:2017 ISO 2470-1:2016</i>	<i>ISO 186:2002</i>
4.	<i>Faktori i shpërndarjes së ndriçimit</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 2469:2007</i>	<i>ISO 186:2002</i>
5.	<i>Tejdukshmëria</i>	<i>CIE illuminant C</i>	<i>SSH ISO 2471-1:2008</i>	<i>ISO 186:2002</i>
6.	<i>Mbetje hirit</i>	<i>0.2% - 100 %</i>	<i>SSH ISO 2144:2019</i>	<i>ISO 186:2002</i>
7.	<i>pH</i>	<i>4-10</i>	<i>SSH ISO 6588-1:2021</i>	<i>ISO 186:2002</i>
8.	<i>Alkalinitetit</i>	<i>0.07-2 mol/kg CaCO3</i>	<i>SSH ISO 10716:2022</i>	<i>ISO 186:2002</i>

[...]

“Për kryerjen e testeve dhe fiksimit të rezultateve duhet të dërgohen në ambientet e laboratorit kampione përfaqësues në mjediset e laboratorit.

.....”

II.14. Për testimin e mostrës së dorëzuar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, me Vendimin nr. 1288/2023, datë 12.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi si më poshtë vijon:

1. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrës së letrës A₄ të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK (lidhur me gramaturën dhe trashësinë) sipas metodës/standardit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit nga laboratorit i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostra e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK është në përputhje me specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group sh.a, OSSH sh.a, FSHU sh.a, FTL sh.a per nje vit” me fond limit 59,032,679.90 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjise Elektrike Group sh.a

2. *Operatori ekonomik "Interlogistic" SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë "Eko-Studio Projekt" SHPK, shumën prej 12,320 lekë pa TVSh për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 18.12.2023 ora 14:30.*
3. *Në datën 18.12.2023 ora 14:30, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a së bashku me mostrat e paraqitura pranë këtij të fundit nga operatori ekonomik "Infosoft Office" SHPK, dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë "Infosoft Office" SHPK, dhe "Interlogistic" SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë "Eko-Studio Projekt" SHPK.*
4. *Të njoftojë laboratorin e shoqërisë "Eko-Studio Projekt" SHPK për kryerjen e testimit të mostrës në datën dhe orën e përcaktuar.*
5. *Afati për kthimin e përgjigjes së testimit brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, nga dita e nesërme e marrjes në dorëzim të mostrave.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.17. Në datën 18.12.2023, në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë "Interlogistic" SHPK, të shoqërisë "Infosoft Office" SHPK, të autoritetit kontraktor dhe KPP-së. Në seancë dëgjimore, pyetjes së KPP-së drejtuar operatorit ekonomik ankimues, nëse ka ngritur pretendime në lidhje me peshimin e një letre apo të rizmës së letrës A4, pasi nuk ka qënë e qartë në ankesë dhe duhej kuptuar nga ana Komisionit, ankimuesi i përgjigjet: *"te dyja rastet dhe të një fije dhe të gjithë rizmës totale"*. Duke qënë se nga sqarimet e dhëna në seancë nga operatori ekonomik ankimues dhe ballafaqimi me përmbajtje e ankesës u sqarua se pretendimi i ankimuesit ngrihet si për gramaturen e një letre A4 ashtu dhe për të gjithë rizmën e saj dhe në vendimin e KPP nr.1288/2023, datë 12.12.2023, ndër të tjera është përcaktuar tarifa vetëm për analizën e gramaturës së 1 fije letre A4, ankimuesit si rezultat i kërkesave paraprake të paraqitura në seance dëgjimore i duhej të paguante një tarifë shtesë prej 6600 lekësh dhe për analizën e gramaturës së një rizme A4 në peshore elektrike.

II.18. Me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 2750/7 prot., datë 18.12.2023 është depozituar në KPP, tarifa financiare që operatori ekonomik "Interlogistic" SHPK duhet të paguante për llogari të shoqërisë "Eko-Studio Projekt" SHPK.

II.19. Me vendimin nr.1333/2023 datë 20.12.2023 KPP vendosi:

1. *Operatori ekonomik "Interlogistic" SHPK, të parapaguajë për llogari të shoqërisë "Eko-Studio Projekt" SHPK, shumën shtesë prej 6600 lekë pa tvsh për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 26.12.2023 ora 11:00.*
2. *Në datën 26.12.2023 ora 11:00, të paraqiten pranë Komisionit të Prokurimit Publik përfaqësues të autoritetit kontraktor Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a dhe përfaqësues të operatorëve ekonomikë "Infosoft Office" SHPK, dhe "Interlogistic" SHPK me autorizim të posaçëm, të cilët në prani të Komisionit të*

Prokurimit Publik do të dorëzojnë mostrat për testim në laboratorin e akredituar pranë shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.

3. *Të njoftojë laboratorin e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK për kryerjen e testimit të mostrës në datën dhe orën e përcaktuar.*
4. *Afati për kthimin e përgjigjes së testimit brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, nga dita e nesërme e marrjes në dorëzim të mostrave.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.20. Me shkresën e protokolluar me nr. 2750/10 prot., datë 26.12.2023, operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK ka depozituar në KPP pagesën e tarifës financiare shtesë për llogari të të shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK.

II.21. Me datë 26.12.2023, në mjediset e KPP-se u mbajt procesverbali me përmbajtje si më poshtë:

“Mbi dorëzimin e mostrës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK pranë laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK

I mbajtur sot me datë 26.12.2023 ora 11:00 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik në prani të Znj. Aurela Gera me detyrë, Inspektor në KPP dhe Znj. Lorina Lako përfaqësues i operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK si dhe znj. Valbona Kadëna përfaqësues i autoritetit kontraktor OSHEE Group sh.a, të cilët do të shoqërojnë dorëzimin e mostrës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK pranë laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK lidhur me ankimin administrativ me nr. 2750 protokolli, viti 2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3575 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group sh.a, OSSH sh.a, FSHU sh.a, FTL sh.a për një vit” me fond limit 59,032,679.90 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 29.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

Perfaqësuesja e autoritetit kontraktor znj. Kadëna theksoi, se nuk e shikon të nevojshme shoqërimin e mostrës për sa kohë e ka admistruar atë në KPP në seancë dëgjimore ndërsa Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK nuk u paraqit pranë KPP-së në datën dhe orën e caktuar sipas vendimit të KPP-së nr.1333/2023, datë 20.12.2023.

II.22. Më datë 26.12.2023, nga verifikimi në vend i laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK, me qëllim dorëzimin e mostrës nga përfaqësuesi i KPP dhe i operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK rezultoi, se stafi i laboratorit testues nuk ishte prezent në këtë datë duke na njoftuar përmes komunikimit telefonik se ishin pushim në këtë datë, si dhe do të na njoftonin përmes komunikimit elektronik zyrtar për datën e dërgimit të mostrës për testim (dokumentuar kjo përmes procesverablit të mbajtur me datë 26.12.2023 nga përfaqësuesi i KPP dhe i operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK).

II.23. Përmes komunikimit elektronik zyrtar i cili u protokollua me tonën me nr. 2750/11 prot., datë 26.12.2023, laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK, ka njoftuar KPP për dërgimin e kampionit të letrës për testim, ditën e mërkurë, datë 27.12.2023, në orën 10:00.

II.24. Në datën 27.12.2023, në mjediset e KPP, u mbajt procesverbali me përmbajtje si më poshtë:

“Mbi dorëzimin e mostrës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK pranë laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK

I mbajtur sot me datë 27.12.2023 ora 09:50 në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik në prani të Znj. Aurela Gera me detyrë, Inspektor në KPP dhe Znj. Lorina Lako përfaqësues i operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK si dhe z. Frederik Prodani administrator i shoqërisë “Infosoft Office” SHPK . Përfaqësuesi i operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK do të shoqërojë dorëzimin e mostrës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK pranë laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK lidhur me ankimin administrativ me nr. 2750 protokollit, viti 2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3575 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group sh.a, OSSH sh.a, FSHU sh.a, FTL sh.a për një vit” me fond limit 59,032,679.90 lekë (pa TVSh), zhvilluar me datë 29.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a. Ndërsa administratori i shoqërisë “Infosoft Office” SHPK theksoi se nuk do të shoqërojë mostrën për dorëzim pranë laboratorit testues Eko Studio Projekt” SHPK.

Përfaqësuesi i autoritetit kontraktor nuk u paraqit pranë KPP-së në datën dhe orën e caktuar njoftuar përmes komunikimit telefonik të kryer me datë 26.12.2023 nga zyra e protokollit të KPP-së.”

II.25. Me anë të shkresës nr.1060 prot., datë 12.01.2024, protokolluar me tonën me nr.2750/12 prot., datë 18.01.2024, “Eko – Studio – Projekt” SHPK ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Raport Testimi” të mostrës, me nr. 1060 Prot., datë 27.12.2023. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm theksohet:

[...] Pika I- Përshkrimi: Analiza e letrës me kod SPS-PS-1060; Shënim : Pranë laboratorit është sjellë një rizëm me fletë A4 ku është zgjedhur rastësisht një flet prej tyre dhe është matur gramatura dhe trashësia.

Pika II- Analiza e letrës me kod SPS-PS-1060; Shënim: Është matur gramatura e të gjithë rizmës A4.

.....

Nr.	Komponentët e matur	Metoda	Të dhënat e matjes		Njësia
			Pika I	Pika II	
1.	Gramatura	ISO:536:2019	75.701		g/m ²
2.	Trashësia	ISO 534:2005	0.106		mm
3.	Gramatura	Iso536;2019		2366.72	g

.....

Bazuar në formulën e sipërpërmendur masa e letrës është 75.701 g/m².”

II.26. Në datën 08.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3579 dhe me nr. 2754/2023 prot., datë 08.11.2023, e operatorit ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Librari Dyrrahu*” SHPK.

II.27. Përmes komunikimit elektronik zyrtar, i cili u protokollua me tonën me nr. 2754/2 prot., datë 09.11.2023, “*Infosoft Office*” SHPK ka sqaruar KPP, se ankesa i përket procedurës së prokurimit me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt “*Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group Sh.A, OSSH Sh.A, FSHU Sh.A, FTL Sh.A për një vit*”, me fond limit: 59,032,679.90 (pesëdhjetë e nëntë milion e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë) lekë pa TVSH dhe se gjatë ngarkimit të ankesës në sistemin elektronik, gabimisht ka vendosur numrin e referencës për procedurën e zhvilluar nga AK Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.A ndërkohë që ankesa i drejtohet vlerësimit të procedurës nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.

II.28. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2754/3 prot., datë 09.11.2023.

II.29. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik i interesuar “*Librari Dyrrahu*” SHPK **nuk ka** dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

II.30. Me shkresën nr. 2754/4 prot., datë 30.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2754/4 prot., datë 30.11.2023, me objekt “*Dërgim dokumentacioni*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*Infosoft Office*” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës për pretendimet e ngritura nga ankimuesi për operatorin ekonomik “*Librari Dyrrahu*” SHPK, duke argumentuar: “*Pretendimet tuaja qëndrojnë pjesërisht dhe arsyetimin po jua paraqesim më poshtë:*

- 1- *Për sa i përket pikës së parë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, Cit: “- Ofertuesi Librari Dyrrahu” sh.p.k nuk ka arritur të vërtetojë kriteret e përgjithshme për kualifikim të përcaktuara në Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit të Shtojcës 7 të DT-së e konkretisht se:- nuk është në proces falimentimi (status aktiv);- nuk është dënuar për ndonjë vepër penale në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*

Rezulton se operatori ekonomik "Librari Dyrrahu" sh.p.k në përmbushje të kësaj kërkesë, ka paraqitur Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit në ditën e hapjes së Ofertës, Shtojcën 8, si dhe dokumentacionin provues që dëshmon se - nuk është në proces falimentimi (status aktiv), -nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 7611 të LPP-së.

Përkatësisht ka paraqitur vërtetim të aksesuar nga e Albania mbi statusin aktiv, si dhe vërtetim nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Pergjithshëm Durrës për subjektin. Pra rezulton e provuar që subjekti ka status aktiv dhe nuk rezulton i dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 7611 të Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik" ndaj nuk përbën shkak për s" kualifikim.

Për sa shpjeguar më lart pretendimi i ankuesit nuk qëndron.

2-Për sa i përket pikës së dytë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit': Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provoje se disponon minimalisht 3 makina transporti në pronësi ose me kontratë qiraje, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës, për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Mjetet e transportit duhet të jenë të pajisura me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, sigurim mjeti dhe certifikatë e kontrollit teknik të mjetit)". Në ankesën Tuaj kerkoni skualifikimin e ofertës së paraqitur nga "LIBRARI DYRRAHU" SHPK, për shkak se, ky ofertues nuk ka arritur të plotësojë me të gjitha të dhënat e kërkuara në shtojcën 7 të DT-së, rubrikat respektive në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-së, e konkretisht në seksionin "Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjesi Kualifikimit" tek B: DEKLARATË (Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme) si dhe nuk ka paraqitur në dokumentacionin e plotë provues në lidhje me 3 mjetet e transportit për mallra, sipas kërkesave të kriterit për kualifikim të përcaktuara në pikën 3 (Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim) të Kriterëve të veçanta të kualifikimit të Shtojcës 7 të DT-së, Lidhur me këtë pretendim sqarojmë se nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, në shtojcën 7 "Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit" ky subjekt ka vetëdeklaruar me korrektesë të dhënat e mjeteve që disponon, duke dhënë informacionin të mjaftueshëm. Se bashku me vetëdeklarimin ka paraqitur edhe dokumentacionin plotësues për mjetet e transportit sipas targave që ka vetëdeklaruar.

Pra sa më sipër pretendimi Juaj nuk qëndron.

3-Përsa i përket pikës së tretë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar ku në cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike të prodhuesit ose ekuivalente. Kjo skedë të jetë e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij për produktin leter A4",*

Sipas argumenteve te paraqitur nga ana juaj, parashtrohet se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt i këtij ankimi, në lidhje me artikullin letër A4, nga ana e autoritetit kontraktor përveç kriterit të përcaktuar në pikën 2.4.4, të Shtojcës 7 të DT-së, me anë të së cilit i ka kërkuar operatorëve ekonomikë që të paraqesin autorizimin e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar ku ne çdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, të dorëzojnë skedën teknike te prodhuesit ose ekuivalente, skedë teknike e cila duhet të jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar dhe ku te jene te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike te Letrës A4 të ofertuar por, gjithashtu ka kërkuar edhe mostër për këtë produkt sipas kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.4.5 të Shtojcës 7 të DT-së.

Sa më sipër përfaqësuesi i autorizuar i shoqërisë “Infosoft Office” SHPK, ka qenë prezent në ditën dhe orën e dorëzimit të mostrave pranë autoritetit kontraktor. Nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë tonë, prezent në momentin e dorëzimit të mostrave nga ana e ofertuesve, u konstatua se, nga ana e ofertuesit “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK është dorëzuar mostër për artikullin Letër A4 e llojit Fabriano, Copy1 class. Prodhuesi i kesaj letre, eshte pikerisht kompania Fabriano SPA pjese e “Fedrigoni Group” -Së pari: Ju bëjmë me dije se, shoqëria “Infosoft Office” SHPK, është distributore e vetme e autorizuar e prodhuesit Fabriano, pjese e “Fedrigoni Group” Itali, për territorin e Shqipërisë. Kjo gje vertetohet lehtesisht ne faqen zyrtare te prodhuesit Fabriano, pjese e “Fedrigoni Group” linku me poshte: <https://fabriano.com/en/contacts-distributors>.

Po ju vendosim ne dispozicion bashkengjitur edhe dokumentin zyrtar qe verteton sa me siper. Per me teper, edhe ju vete mund t'i drejtoheni vete prodhuesit Fabriano, ne adresat zyrtare si vijojne: patrizia.pellegrini@fabriano.com commerciale(ofabriano.com) Ne keto kushte, vetëm shoqëria jonë ka të drejtë t'u japë kompanive që ushtrojnë aktivitetin e tyre ne territorin shqiptar autorizim distributori për produktet e letrës të këtij prodhuesi, pra të Fabriano SPA, pjese e “Fedrigoni Group”, Itali.

Nisur nga fakti se mostra e dorëzuar nga ofertuesi “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK është prodhuar nga Fabriano SPA, detyrimisht ky ofertues do të duhej të dorëzonte autorizimin nga ky prodhues, pra Fabriano, ose autorizimin nga distributori i autorizuar (pra nga kompania Infosoft Office shpk), ku ne cdo rast ofertuesi duhet të provonte me dokumenta lidhjen e distributorit me prodhuesin Fabriano.

Gjithashtu si pjesë të ofertës së tij, ofertuesi detyrimisht duhet të paraqesë në SPE skedën teknike te prodhuesit ose ekuivalente.

Kjo skede duhet të jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, dhe në këtë skedë duhet detyrimisht te jene te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike te tij per produktin leter A4.

Sa më sipër, në kemi bindjen se, ofertuesi “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK nuk ka arritur të provojë se plotëson kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.4.4, të Shtojcës 7 të DT-së pasi për produktin leter A4, me të cilën ka ofertuar:

- Nuk ka arritur të paraqesë autorizimin e prodhuesit apo distributorit te autorizuar, pasi sikurse e shpjeguam edhe më sipër për territorin shqiptar distributor i autorizuar nga prodhuesi është vetëm shoqëria “Infosoft Office” SHPK;

- Edhe në rastin hipotetik se ka paraqitur ndonjë autorizim nga distributorë të prodhuesit që janë dhënë për shtete të tjera dhe jo për territorin shqiptar, kjo shoqëri, pra “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK nuk ka arritur të plotësojë kërkesat e kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.4.4, të Shtojcës 7 të DT-së, pasi nuk ka arritur të paraqesë në SPE dokumentin që verteton lidhjen e prodhuesit Fabriano me distributorin e autorizuar.

SË dyti: Nisur nga fakti se, ne i njohim shumë mire produktet e letrës së prodhuesit Fabriano SPA, jemi të bindur se kjo lloj letre me të cilën ka ofertuar ofertuesi “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK, nuk i plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara tek specifikimet teknike në shtojcën 5 të DT-së. Pikerisht, kjo është arsyeja për të cilën edhe kompania jone, nuk ka mundur të ofertojë me kete lloj letre. (Fabriano Copy 1 class) Konkretisht të dhenat teknike për letren Fabriano Copy 1 class, janë si më poshtë :

Nderkohe që në shtojcën 5 të DT-së të ndryshuar, nisur nga kërkesat për sqarim dhe rekomandimet për plotësim të specifikimeve teknike nga asistencë e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), specifikimet teknike të kërkuara për artikullin Leter A4 janë si më poshtë vijon:
Format A4, “Jo me pak se 78 gr/m² sipas ISO 536” paketuar në rizma 500 flete. I risem me peshe jo me të vogël 2500 gr në peshore elektronike, Bardhësia CIE sipas ISO 11475 jo me pak se 145, me opacitet 79290 sipas ISO 2471, ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470. Trashësia 100-115 sipas ISO 534 Ashpërsia 80 — 180 ml/min sipas ISO 8791 si dhe Rezistenca në përthyerje MD (mN) >100 sipas ISO 2493 Rezistenca në përthyerje CD (mN) >45 sipas ISO 2493 (Double A ose Ekuivalent).

Letra A4 e ofertuar nga ofertuesi “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK, e llojit “COPY 1 class” së pari: - nuk i plotëson specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 të DT-së të plotësuara: - Në skedën teknike të paraqitur nga ofertuesi “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK, në kundërshtim me sa është kërkuar shprehimisht nga AK-ja në kriterin për kualifikim sipas pikës 2.4.4, të Shtojcës 7 të DT-së, nuk gjenden të shprehura të gjitha specifikimet teknike të produktit të letrës A4.

AK-ja e ka kërkuar skedën teknike dhe mostrën e këtij produkti me të vetmin qëllim për të krahasuar përputhshmërinë e specifikimeve të parashtruara në skedën teknike me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Në kushtet kur, në skedën teknike të produktit të letrës A4, të ofertuar nga „ LIBRARI DYRRAHUT” SHPK nuk janë të përshkruara të gjitha të dhënat teknike të kërkuara nga AK-ja, verifikimi nëse, ky produkt, pra kjo lloj letre i plotëson ose jo kërkesat e përcaktuara tek specifikimet teknike, bëhet i pamundur.

Konkretisht: Në skedën teknike të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar (nëse është dorëzuar një e tillë) të letrës A4, e ofertuar nga ofertuesi “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK nuk janë, nuk gjenden specifikimet teknike të mëposhtme: 1Rezistenca në përthyerje MD (mN) “ 100 sipas ISO 2493, 2Rezistenca në përthyerje CD (mN) 7 45 sipas ISO 2493, 3*Ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470. Për më tepër që, 2(dy) nga 3(tre) parametrat e mësipërme bëjnë pjesë tek specifikimet teknike të cilat u shtuan nga autoriteti kontraktor pas shpalljes së procedurës, nisur nga kërkesat për sqarim dhe rekomandimet për plotësim të specifikimeve teknike nga asistencë e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), ndër të tjera edhe për artikullin Leter A4.

Kjo do të thotë se këta parametra teknike të shtuar, janë cilësuar të rëndësishëm dhe detyrimisht duhet të paraqiten në skedat teknike të produkteve të ofertave, për ti bërë të munduar AK-së verifikimin e tyre.

Ky produkt gjithashtu, referuar skedës teknike të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar (nëse është dorëzuar një e tillë) të letrës A4, nuk plotëson parametrat specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5 të DT-së e konkretisht: IËshtë kërkuar nga AK-ja: me opacitet 792.0 sipas ISO 2471. Rezulton se letra A4 e ofertuar nga “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK këtë parametër, referuar skedës teknike e ka: 9170, pra më të ulët sesa minimumi i kërkuar që duhet të jete me i madh se 9290,

Sa më sipër produkti i letrës A4 me të cilin ka ofertuar shoqëria “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, nuk i plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga AK-ja në dokumentet e tenderit. Edhe njëherë theksojmë se është kjo arsyeja se përse shoqëria jonë edhe pse është distributore e autorizuar nga prodhuesi për territorin shqiptar nuk ka ofertuar më këtë lloj letre. Nëse do të pranohej një leter me parametrat e Fabriano Copy 1 class, natyrisht që edhe kompania jone do të kuotonte pikerisht me kete produkt dhe oferta jone do të ishte edhe me ulët, për shkak të statusit preferencial që kemi si distributor i Fabriano dhe cmimeve preferenciale me të cilat furnizohemi.

Per te plotësuar specifikimet teknike, ne kemi ofertuar me një lloj letre e cila është më cilësore dhe sigurisht që ka një cmim më të lartë se letra e ofertuar nga ofertuesi “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK.

Me letren e ofertuar, kemi plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së për sa i përket parametrave të cilësisë, të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Theksojme se artikulli leter A4, ze me shume se 8590 te peshes totale te ofertes, pra ky eshte artikulli me i rendesishem per AK dhe percaktues i ofertes fituese.

KSHA marr shkas nga pretendimet e ngritura nga ana Juaj, ju drejtua zyrtarisht me email – xxxxxxxxxxxxxxxxxxxx me qellim verifikimi dhe kerkoj informacion kush eshte distributori zyrtar per Letren Fabiano —Copy 1 ne Shqiperi.

Ne kthim pergjigjen e dates 19.11.2023 Fabriano konfirmon se distributor zyrtar per te gjitha brandet e letres Fabiano eshte Infosoft. Ne keto kushte KSHA e gjeti te sakte konstatimin tuaj dhe ka vendosur ta pranoje ankesen per kete pike. Gjithashtu, pasi KSHA u konsultuam me skeden teknike te letres te paraqitur nga “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, konkludoi se nuk ka te dhena teknike te plota per specifikimet teknike, perkatesisht per :

-Rezistenca në përthyerje MD (mN) > 100 sipas ISO 2493, 2Rezistenca në përthyerje CD (mN) > 45 sipas ISO 2493: 3-Ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470.

Ne keto kushte e gjejme te drejte konstatimin tuaj dhe vendosim ta pranoje ankesen per kete pike. Referuar legjislacionit të prokurimit publik perkatesisht nenit 92 dhe nenit 82 te VKM 285, ofertuesit janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Pra sa më sipër pretendimi Juaj qëndron.

4-Përsa i përket pikes së katërt të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit: ofertuesi “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, nuk ka argumentuar në përputhje me kërkesat e nenit 93 të

LPP cmimet anomalisht të ulëta të ofertuara në këtë procedurë prokurimi, sqarojme se KSHA ka bere rivleresimin e argumentimit te ofertes te dorezuar me shkresen me nr. 8051 prot., date 16.10.2023 dhe ne perfundim ka arritur ne konkluzion se argumentimi i ofertes nuk eshte bere konform kerkesave te nenit 93, pasi nuk jane argumentuar te gjithe elementet e kerkuar, me konkretisht:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit,*
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhelose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës:*
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi,*
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës:*
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

Pra sa më sipër pretendimi i OE qëndron.

Në përfundim, për gjithcka sa trajtuam më lart, pretendimet Tuaja qëndrojnë pjesërisht ndaj ne përfundim KSHA ka vendosur ta refuzojë oferten e paraqitur nga “Librari Dyrrahu” sh.p.k si jo të pergjegjshme.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën nr. 6413/16 prot., datë 23.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2750/3 prot., datë 30.11.2023, me objekt “Dërgim dokumentacioni”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e pjesshëm të ankesës për pretendimet e ngritura nga ankimuesi për operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK dhe mospranimin e ankesës për pretendimet e ngritura nga ankimuesi për operatorin ekonomik “Infosoft Office” SHPK konkretisht duke argumentuar: “[...] Bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” autoriteti kontraktor vendosi të marrë në shqyrtim ankesën me nr. 2750/2023 Prot., datë 08.11.2023 (paraqitur ne portalin online) në të cilën nga ana Juaj pretendohet se nuk përmbushen kriteret nga operatori ekonomik i renditur i pari në këtë procedurë, “Librari Dyrrahu” sh.p.k.

Pretendimet Tuaja qëndrojnë pjesërisht dhe arsyetimin po jua paraqesim më poshtë:

1-Përsa i përket pikës së parë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit: - “Librari Dyrrahu” SHPK nuk ka mbushur në mënyrë të saktë formularin e përcaktuar në shtojcën 8 KSHA pas verifikimit të dokumentacionit të paraqitur sqaron se shtojca 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” është plotësuar sakte sipas formatit të ri me ndryshimet dhe shtesat përkatëse.

Për sa shpjeguar më lart pretendimi i ankuesit nuk qëndron.

2-Përsa i përket pikës së dytë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit:

- Në dokumentet Standarde të Tenderit në pikën 2.4.4 dhe 2.4.5 parashikohet si më poshte vijon: “2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar ku ne cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike të prodhuesit ose ekuivalente. Kjo skede të jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të jene të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij për produktin leter A4” 2.4.5 Me qëllim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë mostra për letër Ad nje rizem. Mos dorezimi i mostres se kerkuar perben shkak per skualifikim”. Gjithashtu në dokumentet standarde të tenderit “Formulari i specifikimeve teknike ” është kërkuar: Artikulli nr. 1 letër A4 me specifikime teknike “Format A4, jo me pak se 78 grim2 sipas ISO 536, paketuar ne rizma 500 flete. I risem me peshe jo me te vogel 2500 gr ne peshore elektronike, Bardhesia CIE sipas ISO 11475 jo me pak se 145, me Opacitet > 92% sipas ISO 2471, Ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470, Trashësia 100-115 sipas ISO 534, Ashpërsia 80 — 180 ml/min sipas ISO 8791 si dhe Rezistenca në përthyerje MD (mN) >100 sipas ISO 2493, Rezistenca në përthyerje CD (mN) > 45 sipas ISO 2493. (Double A ose Ekuivalent)” Ditën e hapjes së procedurës, përfaqësuesit e kompanisë tonë kanë konstatuar se ofertuesi, Librari Dyrrahu shpk, ka dorëzuar si moster të artikullit letër, Markën COPY 1. Kompania jonë Interlogistic shpk është tregtar prej shumë vitesh gjithashtu i letres COPY 1 dhe disponojmë skeden teknike të COPY 1, ku skeda teknike e kësaj marke nuk përmbush të gjithë parametrat e kërkuar në DST nga ana e autoritetit kontraktor dhe si e tillë duke qënë se nuk përmbush kriterin “2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar ku ne cdo rast të dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike të prodhuesit ose ekuivalente. Kjo skede të jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të jene të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij për produktin leter A4”, ofertuesi duhet të ishte skualifikuar nga procedura e prokurimit. Në lidhje me skedën teknike të COPY 1, vihet re se mungojnë parametrat Rezistenca në përthyerje MD (mN) > 100 sipas ISO 2493, Rezistenca në përthyerje CD (mN) > 45 sipas ISO 2493. Nga sa më sipër konstatuam, në lidhje me të gjitha mangësitë e konstatuara ofertuesi duhet të ishte skualifikuar nga procedura e prokurimit.

Sqarojme se KSHA nga verifikimi i skedes teknike të paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” sh.p.k ka verifikuar qe nuk ka të dhena për specifikimet teknike të kërkuara – Rezistenca në përthyerje MD (mN) >100 sipas ISO 2493, Rezistenca në përthyerje CD (mN) > 45 sipas ISO 2493.

Gjithashtu KSHA marre shkas nga pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” shp.k dhe nga ankesa juaj, ju drejtua zyrtarisht me email – xxxxxxxxxxxxxxxxxxxxxx

me qellim verifikimi dhe kerkoi informacion kush eshte distributori zyrtar per Letren Fabiano —Copy l ne Shqiperi.

Ne kthim pergjigjen e dates 19.11.2023 Fabriano, konfirmon se distributor zyrtar per te gjitha brandet e letres Fabriano eshte Infosoft.

Ne keto kushte KSHA e gjeti te sakte konstatimin Tuaj dhe ka vendosur ta pranoje ankesen per kete pike.

Pretendohet nga ana Juaj se operatori ekonomik “Infosoft Office“ sh.p.k nuk ka paraqitur skedën teknike të prodhuesit (ose ekuivalente), skedë teknike e cila duhet të jetë e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të jenë të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij për produktin leter A4.

Pra sa më sipër pretendimi Juaj qëndron.

3-Përsa i përket pikes së tretë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit”:
- Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” sh.p.k, ka paraqitur një ofertë ekonomike tërësisht anomalisht të ulët. Fondi limit i përcaktuar në DST për këtë procedurë prokurimi është 59,032,679.90 (pesëdhjetë e nëntë milion e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë nëntëdhjetë) leke pa TVSH dhe oferta ekonomike e paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” është në vlerën e 29 000 000 (njëzet e nëntë milion) Lekë pa TYSH. Thënë ndryshe kjo ofertë është 49% (dyzet e nëntë për qind) më e ulët se vlera e fondit limit. Në zbatim të nenit 93, pika 1, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, dhe nenit 82, pika 4 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke iu referuar procedurës prokurore të lartpërmendur, kjo ofertë do të duhet të konsiderohet i) anomalisht e ulët, dhe si rrjedhojë të konsiderohet ii) e papranueshme nga AK. Më poshtë Ju parashtrojmë në mënyrë të detajuar se ky operator ekonomik, bazuar në çmimet për njësi të ofertuara, dhe vlerës totale të ofertuar nuk arrin të realizojë pjesën dërrmuese të artikujve mallrave të kërkuara nga DST për këtë procedurë të prokurimit publik.... KSHA ka bere rivlerësimin e argumentimit te ofertes anomalisht te ulet, te dorezuar me shkresen me nr. 8051 prot., date 16.10.2023 dhe ne perfundim ka arritur ne konkluzion se argumentimi i ofertes nuk eshte bere konform kerkesave te nenit 93, pasi nuk jane argumentuar te gjithë elementet e kerkuar, më konkretisht:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit,

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës:

c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi,

ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës:

d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Pra sa më sipër pretendimi Juaj qëndron.

Në përfundim, për gjithçka sa trajtuam më lart, pretendimet Tuaja qëndrojnë pjesërisht ndaj ne përfundim KSHA ka vendosur ta refuzojë ofertën e paraqitur nga “Librari Dyrrahu” sh.p.k si jo të përgjegjshme.

II-Bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” autoriteti kontraktor vendosi të marr në shqyrtim ankesën me nr. 2750/2023 Prot., datë 08.11.2023 (paraqitur në portalin online) në të cilën nga ana Juaj pretendohet se nuk përmbushen kriteret nga operatori ekonomik i renditur i dyti në kete procedurë, “InfoSoft Office” sh.p.k.

Pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë dhe arsyetimin po jua paraqesim më poshtë:

1-Përsa i përket pikës së parë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit: - Në lidhje me shtojcën e mësipërme pretendojmë që ofertuesi InfoSoft Office, nuk ka mbushur në mënyrë të saktë formularin e përcaktuar në shtojcën 8, duke mos deklaruar saktë aksioneret e tij më saktë Dobi Management. Pretendimin e mësipërm e mbështesim në faktin që Agjencia e Prokurimit Publik me anë të njoftimit nr. 6776 datë 05.10.2.2022 me lëndë “Autoriteteve/Enteve, Operatorëve ekonomike”, njofton të gjitha subjektet e interesuara të cilat merren me prokurime, se ka miratuar disa ndryshime shtesa në setet e DST për mallra, punë, shërbime. Në bazë të njoftimit të lartpërmendur, APP ka bërë disa ndryshime në DST konkretisht në shtojcën 8 duke pasqyruar ndryshimet të cilat nëse nuk mbahen parasysh nga ana e operatorëve ekonomike ofertues, detyrojnë autoritetet entet kontraktore në skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit. Sa më sipër pretendojmë që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk ka kontrolluar në mënyrë të saktë shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” (sipas ndryshimeve) të paraqitur në sistemin elektronik të APP-së nga ana e ofertuesit InfoSoft Office duke e skualifikuar atë.

KSHA ka bërë verifikimin e shtojcës 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” të paraqitur nga ofertuesi “InfoSoft Office” dhe ka vlerësuar se është plotësuar saktë sipas formatit të ri me ndryshimet dhe shtesat perkatëse.

Pra sa më sipër pretendimi Juaj nuk qëndron.

2-Përsa i përket pikës së dytë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit: - Në dokumentet Standarde të Tenderit në pikën 2.4.4 dhe 2.4.5 parashikohet si më poshtë vijon: “2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar ku ne çdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike të prodhuesit ose ekuivalente. Kjo skedë të jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku të jete të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij për produktin leter A4” 2.4.5 Me qellim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë mostra për letër A4 një rizem. Mosdorezimi i mostres se kerkuar perben shkak per skualifikim”. Gjithashtu në dokumentet standarde të tenderit “Formulari i specifikimeve teknike” është kërkuar: Artikulli nr. 1 letër A4 me specifikime teknike “Format A4, jo me pak se 78 gr/m2 sipas ISO 536, paketuar ne rizma 500 flete. 1 risem me peshe jo me te vogel 2500 gr ne peshore elektronike, Bardhesia CIE sipas ISO 11475 jo me pak se 145, me Opacitet >92% sipas ISO 2471, Ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470, Trashësia 100-115 sipas ISO 534, Ashpërsia 80 — 180 m/min sipas ISO 8791 si dhe Rezistenca në përthyerje MD (mN) - 100 sipas ISO 2493, Rezistenca në përthyerje CD (mN) 2 45 sipas ISO 2493. (Double A ose Ekuivalent)” Ditën e hapjes së procedurës, përfaqësuesit e kompanisë tonë kanë konstatuar se ofertuesi, Infosoft Office ShPK, ka dorëzuar si moster të artikullit letër, Markën

Navigator. Nga lundrimi në faqen zyrtare të prodhuesit të Navigator, konstatoam se skeda teknike kësaj marke nuk përmbush të gjithë parametrat e kërkuar në DST nga ana e autoritetit kontraktor dhe si e tillë duke qenë se nuk përmbush kriterin “2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar ku ne çdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike të prodhuesit ose ekuivalente. Kjo skede te jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku te jene te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike te tij për produktin letër A4”, ofertuesi duhet të ishte skualifikuar nga procedura e prokurimit. Ne si kompani pretendojmë që marka Navigator e dorëzuar nga ofertuesi Infosoft Office ShPK, nuk është sipas specifikimeve teknike të kërkuara në DST. Ne duam që të gjithë operatorët të krahasohen me të njëjtin standard letre dhe të njëjtat parametra të kërkuara në DST, prandaj kërkojme që kjo moster të përmbushi specifikimet teknike të kërkuara. Në Dokumentet Standarde të Tenderit, të publikuara nga autoriteti kontraktor, artikulli Letër A4 përbën mbi 80% të produkteve të kërkuara në vlerë dhe volum, nga ana e autoritetit dhe mungesa e elementëve të sipërcituar për këtë artikull përbën një kërcënim serioz që në magazinat e autoritetit të vijë një mall jo i duhur dhe jo konform specifikimeve teknike duke i shkaktuar në këtë mënyrë një dëm ekonomik buxhetit të shtetit.

Nga kontrolli i dokumentacionit te paraqitur ne SPE nga ana e shoqërisë ofertuese Infosoft Office ShPK ne përmbushje te kësaj pike, rezulton qe eshte paraqitur ne formen e kerkuar autorizimi i prodhuesit te letren me te cilen ka ofertuar, si dhe skeda teknike e certifikuar nga distributori i autorizuar, ku jane te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike per produktin leter A4. Referuar specifikimeve teknike te pasqyruara ne skede teknike rezulton se letra me te cilen ka ofertuar subjekti Infosoft Office ShPK ploteson te gjitha specifikimet teknike te kerkuar ne dokumente tenderi.

Pra sa më sipër pretendimi Juaj nuk qëndron.

Në përfundim për gjithçka sa trajtuam më lart, pretendimet Tuaja nuk qëndrojnë ndaj ne përfundim KSHA ka vendosur ta refuzojë ankesën lidhur me subjektin “Infosoft Office” ShPK.”

II.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” nuk ka paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik argumente në cilësinë e subjektit të interesuar në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe rrjeshimisht ka humbur edhe të drejtën për të paraqitur ankesë njëherazi pranë KPP dhe autoritetit kontraktor në lidhje me vendimmarrjen e këtij të fundit mbi ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK. Akoma më tej, operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK është njohur me formularin për publikim dhe pretendimet e operatorit ekonomik “Interlogistic” mbi kualifikimin e tij që me datë 09.11.2023 dhe ku për përmbajtjen e këtij formulari nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim, si dhe nuk ka ezauruar hapin procedural të paraqitjes së argumenteve brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 113 të LPP-së. Për këtë fakt, bazuar në nenin 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK dhe do të vazhdojë shqyrtimin në themel për pjesën tjetër të ankesë .

III.1.5. Sa më sipër, në kushtet kur autoriteti kontraktor ka pranuar një pjesë të pretendimeve të palës ankimuese për operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, KPP gjykon, se pretendimet e tjera nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, me arsyetimin se ky i fundit nuk ka plotësuar sipas shtojcave të reja të ndryshuara nga APP, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, duke mos deklaruar saktë aksionerët e tij, më konkretisht Dobi Management, KPP vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7, “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit, është parashikuar si vijon:

Shtojca 7

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);*
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;*
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose/që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;*
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;*
dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;*
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.*
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.*

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

III.2.2. Në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pjesë e dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----

Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT-i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>				
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>				
<hr/>				
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
<hr/>				

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.
Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):

a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;

□

b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).

□

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:

- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).

9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: <ul style="list-style-type: none">- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të

Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit të Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.

- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

III.2.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, rezulton, se ka paraqitur në SPE dokumentacionin me emërtimin:

- Shtojca 8 – Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit, ku në Pjesa II, pika B, “Deklarata për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit” është plotësuar si vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

1. Unë i nënshkruari **F** _____ **P** _____, në cilësinë e **Administratorit** të operatorit ekonomik **InfoSoft Office shpk**, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	InfoSoft Office sh.p.k
Numri NIPT/et:	J62426002Q
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	Autostrada Tirane – Durres, km 8, Kashar, Tirane, Shqiperi Kodi postar 1051
Përfaqësuesi (emri):	F P
Telefoni:	
E-mail:	

B: DEKLARATË

-

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>F. P (Administrator) E. P (Drejtoreshe Shitjesh dhe Marketingu) G. D (Drejtor Ekzekutiv) DOBI Management me perfaqesues ligjor E. D (Ortak) etj,</p>
<p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

III.2.4. Në nenin 76, “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;
- e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

- a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;
- c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;
- ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

- a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

- b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;
- c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;
- d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;
- e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.
- ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriteve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;
- f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.
- g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.
5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.
6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.2.5. Në nenin 77, pika 1, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.2.6. Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.7. Në nenin 26, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.
- Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.
- Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.
7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.9. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Interlogistic" SHPK me arsyetimin, se operatori ekonomik "Infosoft Office" SHPK nuk ka plotësuar sipas shtojcave të reja të ndryshura nga APP, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, duke mos deklaruar saktë aksionerët e tij,, më konkretisht Dobi Management, KPP konstaton, se nga verifikimi i Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit "Infosoft Office" SHPK, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton, se ortakë të shoqërisë "Infosoft Office" SHPK janë: z.F.P. dhe "Dobi Management" SHPK. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet, se operatori ekonomik "Infosoft Office" SHPK ka dorëzuar Shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit". Nga shqyrtimi i saj, rezulton se në Pjesën II, pika B, "Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit", ka plotësuar paragrafin si më poshtë shënuar:

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

F.P (Administrator)

E. P (Drejtoreshë shitjesh dhe Marketingu)

G.D (Drejtor Ekzekutiv)

Dobi Management me përfaqësues ligjor E.D (Ortak) etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Komisioni gjykon, se plotësimi i këtij paragrafi të formularit të vetëdeklarimit në shtojcën 8-të dokumenteve të tenderit, është në përputhje me gjendjen reale që pasqyron ekstrakti i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, pasi operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK ka deklaruar edhe për ortakun e tij “Dobi Menagement” SHPK. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “InfoSoft office” SHPK, e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pikën 1/d të Shtojcës 7 të saj, për dhënien e informacionit të plotë dhe të saktë në Formularin e Vetëdeklarimit, pasi në dokumentacionin e ngarkuar në SPE është deklaruar edhe për ortakun “Dobi Menagement” SHPK, që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP, ose ka qenë dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5 - vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft office” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, “Interlogistic” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, për mospërmbushjen e kriterit “2.4.5 Me qellim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë mostra për letër A4 nje rizem. Mos dorezimi i mostres se kerkuar perben shkak per skualifikim”, me argumentin se operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK“ nuk përmbush kërkesat e autoritetit kontraktor, për sa i përket specifikimeve teknike për letrën A4 dhe për këtë kërkohet testimi i mostrës së letrës A4 sipas parametrave të kërkuar në DST...”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.4 “Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim” pika 2.4.5, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, përcaktohet si më poshtë:

2.4.5. Me qellim për të krahasuar përputhshmërinë me specifikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë mostra për letër A4 nje rizem. Mos dorezimi i mostres se kerkuar perben shkak per skualifikim.

III.3.2. Në shtojcën 5, “Formulari i specifikimeve teknike” të modifikuar, për letrën A4 përcaktohet si më poshtë:

Format A4, jo me pak se 78 gr/m2 sipas ISO 536, paketuar ne rizma 500 flete.1 risem me peshe jo me te vogel 2500 gr ne peshore elektronike, Bardhesia CIE sipas ISO 11475 jo me pak se 145, me opacitet >92% sipas ISO 2471, ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470. (Double A ose Ekuivalent), Trashësia 100-115, sipas ISO 534, Ashpërsia 80 — 180 ml/min

sipas ISO 8791, Rezistenca në përthyerje MD (mN) > 100, sipas ISO 2493, Rezistenca në përthyerje CD (mN) > 45 sipas ISO 2493.

III.3.3. Nga verifikimet e kryera për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimes “Infosoft Office” SHPK, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- *Mostrën e dorëzuar*

III.3.4. Në nenin 77, pika 1 dhe pika 4, “Kërkesat për kualifikim” i ligjit 162/2020, “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.3.5. Në nenin 40, pika 6, germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me

kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;

III.3.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.3.7. Referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht, se me qëllim për të krahasuar përputhshmërinë me specififikimet teknike të kërkuara, në datën e hapjes së ofertave, operatori ekonomik ofertues duhet të dorëzojë mostra për letër A4 (një rizem). Mosdorëzimi i mostrës së kërkuar përbën shkak për skualifikim.

III.3.8. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, konkretisht nga shqyrtimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, KPP konstatoi, se ky i fundit ka paraqitur pranë autoritetit kontraktor mostrën Letër A4 (1 rizem).

III.3.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor, me qëllim shqyrtimin e drejtë të pretendimeve të ankimuesit, KPP gjykoj të domosdoshme kryerjen e testimit të mostrës së paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, me qëllim verifikimin e përmbushjes së specifikimeve teknike të mostrës së dorëzuar. Në përgjigje të shkresës së Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 641/11 prot., datë 04.05.2022, me objekt: *“Kërkesë për informacion”*, me shkresën nr. 185/1 prot., datë 09.05.2022 Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit informon KPP-në se: *“[...] laborator i vetëm i akredituar prej saj për testimin e letrës dhe kartonit është Eko-Studio Projekt SHPK me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nr.48, Tiranë”*.

Ndërsa në datën 25.01.2023 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2710/8 prot., shkresa e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK me nr. 47 prot., datë 23.01.2023, me objekt: *“Kthim - përgjigje shkresës me nr. 2710/7 prot., datë 17.01.2023”*. Me anë të kësaj shkrese KPP bëhet me dije se:

“[...] Eko Studio Projekt SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve ndër të tjerë dhe të [...] letrës dhe kartonit.”

Për kryerjen e matjeve laboratorike Eko – Studio –Projekt është e pajisur me Certifikatë Akreditimi me numër Regjistrimi LT 070, konform standardit S SH ISO/IEC 17025:2017, të

lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me ligjin Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim tabela me standardet e provës dhe të mostrimit dhe sqarimin se:

<i>Letër – Karton – Brumë Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi Provës</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standardi Provës</i>	<i>Standardi Mostrimit</i>
<i>1.</i>	<i>Densiteti</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
<i>2.</i>	<i>Gramatuara</i>	<i>0g-120g 0g-2000g</i>	<i>SSH ISO 536:2020</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
<i>3.</i>	<i>Trashësia</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
<i>4.</i>	<i>Volum Specifik</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>

“Kryejmë edhe testim dhe matje të komponentëve të letrës dhe kartonit sipas standardeve të përcaktuara në vijim:

<i>Letër – Karton – Brumë Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi Provës</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standardi Provës</i>	<i>Standardi Mostrimit</i>
<i>1.</i>	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-3000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
<i>2.</i>	<i>Ashpërsia/Lëmueshmëria</i>	<i>5ml/min-5000 ml/min</i>	<i>ISO 8791-2:2013</i>	<i>ISO 186:2002</i>
<i>3.</i>	<i>Bardhësia</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 11475:2017 ISO 2470-1:2016</i>	<i>ISO 186:2002</i>
<i>4.</i>	<i>Faktori i shpërndarjes së ndriçimit</i>	<i>L:0-100</i>	<i>ISO 2469:2007</i>	<i>ISO 186:2002</i>
<i>5.</i>	<i>Tejdukshmëria</i>	<i>CIE illuminant C</i>	<i>SSH ISO 2471-1:2008</i>	<i>ISO 186:2002</i>
<i>6.</i>	<i>Mbetje hirit</i>	<i>0.2% - 100 %</i>	<i>SSH ISO 2144:2019</i>	<i>ISO 186:2002</i>
<i>7.</i>	<i>pH</i>	<i>4-10</i>	<i>SSH ISO 6588-1:2021</i>	<i>ISO 186:2002</i>
<i>8.</i>	<i>Alkalinitetit</i>	<i>0.07-2 mol/kg CaCO3</i>	<i>SSH ISO 10716:2022</i>	<i>ISO 186:2002</i>

“Për kryerjen e testimeve dhe fiksimit të rezultateve duhet të dërgohen në ambientet e laboratorit kampione përfaqësues në mjediset e laboratorit.”

Gjithashtu, në datën 06.02.2023, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 2710/9 prot., shkresa e shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK me nr. 47/2 prot., datë

23.01.2023, me objekt: “Kthim - përgjigje shkresës me nr. 2710/7 prot., datë 17.01.2023”.
Me anë të kësaj shkrese, KPP bëhet me dije se:

“[...] Eko Studio Projekt SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve ndër të tjerë dhe të [...] letrës dhe kartonit.”

Për kryerjen e matjeve laboratorike Eko – Studio –Projekt është e pajisur me Certifikatë Akreditimi me numër Regjistrimi LT 070, konform standardit S SH ISO/IEC 17025:2017, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me ligjin Nr. 116/2014 “Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë”.

Në vijim tabela me standardet e provës dhe të mostrimit dhe sqarimin se:

<i>Letër – Karton – Brumë Letre</i>				
<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi Provës</i>	<i>Fusha Provës</i>	<i>Standardi Provës</i>	<i>Standardi Mostrimit</i>
1.	<i>Densiteti</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
2.	<i>Gramatuara</i>	<i>0g-120g 0g-2000g</i>	<i>SSH ISO 536:2020</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
3.	<i>Trashësia</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>
4.	<i>Volum Specifik</i>	<i>70 µm – 180 µm</i>	<i>SSH EN ISO 534:2011</i>	<i>SSH EN ISO 186:2002</i>

[...]

“Për kryerjen e testeve dhe fiksimit të rezultateve duhet të dërgohen në ambientet e laboratorit kampione përfaqësues në mjediset e laboratorit.”

Në datën 12.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin nr. 1288/2023, për kryerjen e ekspertizës për analizimin e mostrës së letrës A4 të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK (lidhur me gramaturën dhe trashësinë), sipas metodës/standardit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit nga laboratorit i akredituar i shoqërisë “Eko-Studio Projekt” SHPK, nëse mostra e paraqitur është në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “Infosoft Office” për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Në datën 18.12.2023, në mjediset e Komisionit të Prokurimit Publik, u mbajt një seancë dëgjimore me përfaqësues të operatorëve ekonomikë “Interlogistic” SHPK, dhe “Infosoft Office” SHPK, përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe KPP-së. Me vendimin e KPP të datës 20.12.2023, u pranuan kërkesat paraprake të ankimuesit, të paraqitura në seancë dëgjimore, që testimi i mostrës të kryehej jo vetëm për një fije të letrës A4, por edhe për të gjithë rizmën e letrës A4 të paraqitur si mostër nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, pranë autoritetit kontraktor, duke vendosur edhe për pagimin e një tarife shtesë nga ankimuesi për llogaritë të laboratorit testues. Me datë 26.12.2023, u paraqitën në mjediset e KPP-së, përfaqësues të ankimuesit dhe autoritetit kontraktor (i cili refuzoi shoqërimin e mostrës) për dorëzimin e mostrës pranë laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK. Në këtë datë rezultoi, se punonjësit e stafit të laboratorit testues ishin pushim (dokumentuar kjo përmes procesverbalit të mbajtur me datë 26.12.2023 në mjediset e këtij laboratorit) dhe pas

njofitimit të tyre përmes komunikimit elektronik zyrtar mbi datën e dorëzimit të mostrës, me 27.12.2023, u bë dorëzimi i saj në laboratorin testues nën shoqërimin e ankimuesit, ndërsa operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK refuzoi të shoqëronte mostrën.

Me anë të shkresës nr.1060 prot., datë 12.01.2024, protokolluar me tonën me nr.2750/12 prot., datë 18.01.2024, “Eko – Studio – Projekt” SHPK, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “Raport Testimi” të mostrës, me nr. 1060 Prot., datë 27.12.2023. Konkretisht, ndër të tjera në raportin e mësipërm theksohet:

[...] *Pika I- Përshkrimi: Analiza e letrës me kod SPS-PS-1060; Shënim : Pranë laboratorit është sjellë një rizëm me fletë A4 ku është zgjedhur rastësisht një flet prej tyre dhe është matur gramatura dhe trashësia.*

Pika II- Analiza e letrës me kod SPS-PS-1060; Shënim: Është matur gramatura e të gjithë rizmës A4.

.....

Nr.	Komponentët e matur	Metoda	Të dhënat e matjes		Njësia
			Pika I	Pika II	
1.	Gramatura	ISO:536:2019	75.701		g/m ²
2.	Trashësia	ISO 534:2005	0.106		mm
3.	Gramatura	Iso536;2019		2366.72	g

.....

Bazuar në formulën e sipërpërmendur masa e letrës është 75.701g/m².”

III.3.10. KPP referuar Raportit të Testimit të mostrës, me nr. 1060 Prot. datë 27.12.202, dërguar në KPP me anë të shkresës nr.1060 prot., datë 12.01.2024, protokolluar me tonën me nr.2750/12 prot., datë 18.01.2024, nga Laboratori “Eko – Studio – Projekt” SHPK, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave të sipërpërmendura, konstaton, se mostra e paraqitur për testim nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, nuk është në përputhje me specifikimet teknike lidhur me peshën e një fije letër A4 dhe të rizmës së letrës A4, pasi masa mesatare e një fijeje letre A4 sipas raportit të testimit të laboratorit “Eko – Studio – Projekt” SHPK është 75.701 g/m², ndërkohë në specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pesha e një flete A4 duhet të jetë *jo më pak se 78 gr/m²*, si dhe pesha e rizmës A4 sipas raportit të testimit është 2366.72 g, ndërkohë në specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor pesha e rizmës me 500 fletë duhet të jetë *jo më pak se 2500 gr*. Ndërsa lidhur me trashësinë, KPP referuar raportit të testimit më sipër vëren se ajo është në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, pasi sipas raportit të testimit rezulton, se ajo është 0.106 mm, ndërsa në specifikime teknike ajo është përcaktuar *100-115*.

Në përfundim, sa më sipër analizuar, nga verifikimi i dokumentacionit dhe Raportit të Testimit të mostrës (nr.1060 prot., datë 12.01.20224) të Laboratorit të akredituar “Eko – Studio – Projekt” SHPK, konstatohet, se mostra për letrën A4, nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në lidhje me gramaturën e një fijeje si dhe të rizmës, ndërsa është në përputhje me specifikimet teknike në lidhje me trashësinë.

Në këto kushte KPP gjykon, se mostra referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor, për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të siguruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, sipas treguesve të raporteve të testimit të kryer nga laboratorit “Eko-Studio-Projekt” SHPK rezultojnë, se për peshën e letrës A₄ (për 1 (një) fletë dhe për 1 (një) rizëm), operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me mostrën e dorëzuar nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ndërsa për trashësinë e letrës A₄ i përmbush specifikimet teknike, çka sjell përmbushjen në mënyrë të pjesshme dhe jo të plotë të specifikimeve teknike për komponentët të cilët iu nënshtruan testimit (gramatura e një fijeje dhe e rizmes së letrës A₄), ku për testimin e të cilëve, referuar faqes zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit rezultojnë, se është i akredituar laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK me numër akreditimi LT 070, datë 12.02.2022 dhe me vlefshmëri deri në datën 10.02.2026.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK, qëndron pjesërisht.

III.3.11. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK, për mospërmbushjen e specifikimeve të tjera teknike për letrën A₄ nga operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, gjykojmë, se duke qenë se laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK me nr. certifikimi LT 070, datë 12.02.2022 dhe me vlefshmëri deri në 10.02.2026 është i certifikuar vetëm për densitetin e letrës/kartonit, gramaturën e letrës/kartonit, volumin specifik të letrës/kartonit, si dhe trashësinë e letrës/kartonit dhe jo për të gjitha specifikimet teknike për të cilat shfaqen pretendime dhe ku pas arsyetimit më sipër të KPP, mbi pretendimet e ankimuesit për gramaturën dhe trashësinë e letrës A₄, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit dhe pretendimet e tjera nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “Interlogistic” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK nga procedura e prokurimit, me pretendimin se nuk përmbush kriterin 2.4.4 në kriteret e tjera të vecanta për kualifikim, konkretisht sipas tij skeda teknike e markës Navigator nuk përmbush të gjitha parametrat e kërkuar në DST, KPP në këtë rast gjykon, se duke iu referuar arsyetimit më sipër të KPP, ku bazuar në raportin e testimit të laboratorit testues “Eko-Studio Projekt” SHPK, “Raportit të Testimit të mostrës (nr.1060 prot., datë 12.01.2022)”, operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK nuk përmbush specifikimet teknike në lidhje me gramaturën e 1 fije letër, si dhe të gjithë rizmës së letrës A₄ dhe rrjedhimisht duke ndryshuar edhe gjendjen juridike dhe faktike të operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK nga i kualifikuar në të skualifikuar, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim, pasi në vetvete skeda teknike paraqet një panoramë të përmbushjes ose jo të specifikimeve teknike, për të cilat KPP është shprehur më sipër në këtë vendim.

Sa më sipër këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Me shkresën nr. 2754/4 prot., datë 30.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2754/4 prot., datë 30.11.2023, me objekt “Dërgim dokumentacioni”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, akti mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Office” SHPK, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranimin e pjesëshëm të ankesës për pretendimet e ngritura nga ankimuesi për operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK duke argumentuar: “Pretendimet tuaja qëndrojnë pjesërisht dhe arsyetimin po jua paraqesim më poshtë:

1- Për sa i përket pikës së parë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, Cit: “- Ofertuesi Librari Dyrrahu” sh.p.k nuk ka arritur të vërtetojë kriteret e përgjithshme për kualifikim të përcaktuara në Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit të Shtojcës 7 të DT-së e konkretisht se:- nuk është në proces falimentimi (status aktiv);- nuk është dënua për ndonjë vepër penale në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

Rezulton se operatori ekonomik “Librari Dyrrahu“ sh.p.k në përmbushje të kësaj kërkesë, ka paraqitur Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit në ditën e hapjes së Ofertës, Shtojcën 8, si dhe dokumentacionin provues që dëshmon se - nuk është në proces falimentimi (status aktiv), -nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së.

Përkatësisht ka paraqitur vërtetim të aksesuar nga e albania mbi statusin aktiv, si dhe vërtetim nga Gjykata e shkalles së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës për subjektin. Pra rezulton e provuar që subjekti ka status aktiv dhe nuk rezulton i dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik” ndaj nuk përbën shkak për skualifikim.

Për sa shpjeguar me lart pretendimi i ankuesit nuk qëndron.

2- Për sa i përket pikës së dytë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit: Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provoje se disponon minimalisht 3 makina transporti në pronësi ose me kontrate qiraje, me afat kohëzgjatje për të gjithë kohën e vazhdimësisë së kontratës, për këtë duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës sipas legjislacionit në fuqi. Mjetet e transportit duhet të jenë të pajisura me dokumentacion përkatës sipas legjislacionit në fuqi (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, siguracion mjeti dhe certifikate e kontrollit teknik të mjetit)”. Në ankesën Tuaj kerkoni skualifikimin e ofertës së paraqitur nga “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, për shkak se, ky ofertues nuk ka arritur të plotësojë me të gjitha të dhënat e kërkuara në shtojcën 7 të DT-së, rubrikat respektive në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DT-së, e konkretisht në seksionin “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes Kualifikimit” tek B: DEKLARATË (Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme) si dhe nuk ka paraqitur në dokumentacionin e plotë provues në lidhje me 3 mjetet e transportit për mallra, sipas kërkesave të kriterit për kualifikim të përcaktuara në pikën 3 (Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim) të Kriterëve të veçanta të

kualifikimit të Shtojcës 7 të DT-së, Lidhur me këtë pretendim sqarojmë se nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar, ne shtojcën 7 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” ky subjekt ka vetëdeklaruar me korrektesi te dhenat e mjeteve qe disponon, duke dhene informacionin te mjaftueshem. Se bashku me vetëdeklarimin ka paraqitur edhe dokumentacionin plotësues për mjetet e transportit sipas targave qe ka vetëdeklaruar.

Pra sa më sipër pretendimi Juaj nuk qëndron.

3-Përsa i përket pikës së tretë të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit:

- Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike te prodhuesit ose ekuivalente. Kjo skede te jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku te jene te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike te tij per produktin leter A4”,

Sipas argumenteve te paraqitur nga ana juaj, parashtrohet se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt i këtij ankimi, në lidhje me artikullin letër A4, nga ana e autoritetit kontraktor përveç kriterit të përcaktuar në pikën 2.4.4, të Shtojcës 7 të DT-së, me anë të së cilit i ka kërkuar operatorëve ekonomikë që të paraqesin autorizimin e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar ku ne çdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, të dorëzojnë skedën teknike te prodhuesit ose ekuivalente, skedë teknike e cila duhet të jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar dhe ku te jene te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike te Letrës A4 të ofertuar por, gjithashtu ka kërkuar edhe mostër për këtë produkt sipas kriterit për kualifikim të përcaktuara në pikën 2.4.5 të Shtojcës 7 të DT-së.

Sa më sipër përfaqësuesi i autorizuar i shoqërisë “Infosoft Office ” SHPK, ka qenë prezent në ditën dhe orën e dorëzimit të mostrave pranë autoritetit kontraktor. Nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë tonë, prezent në momentin e dorëzimit të mostrave nga ana e ofertuesve, u konstatua se, nga ana e ofertuesit “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK është dorëzuar mostër për artikullin Letër A4 e llojit Fabriano, Copy1 class. Prodhuesi i kësaj letre, është pikërisht kompania Fabriano SPA pjese e “Fedrigoni Group” -Së pari: Ju bëjmë me dije se, shoqëria “Infosoft Office” SHPK, është distributore e vetme e autorizuar e prodhuesit Fabriano , pjese e “Fedrigoni Group” Itali, për territorin e Shqipërisë. Kjo gje vertetohet lehtesisht ne faqen zyrtare te prodhuesit Fabriano, pjese e “Fedrigoni Group” linku me poshte : <https://fabriano.com/en/contacts-distributors>.

Po ju vendosim ne dispozicion bashkengjitur edhe dokumentin zyrtar qe verteton sa me siper. Per me teper, edhe ju vete mund t'i drejtoheni vete prodhuesit Fabriano, ne adresat zyrtare si vijojne: patrizia.pellegrini(Qfabriano.com commerciale(ofabriano.com Ne keto kushte, vetëm shoqëria jonë ka të drejtë t'u japë kompanive që ushtrojnë aktivitetin e tyre ne territorin shqiptar autorizim distributori për produktet e letrës të këtij prodhuesi, pra të Fabriano SPA, pjese e “Fedrigoni Group”, Itali.

Nisur nga fakti se mostra e dorëzuar nga ofertuesi “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK është prodhuar nga Fabriano SPA, detyrimisht ky ofertues do të duhej të dorëzonte autorizimin nga ky prodhues, pra Fabriano, ose autorizimin nga distributori i autorizuar (pra nga kompania

Infosoft Office ShPK), ku ne çdo rast ofertuesi duhet të provonte me dokumente lidhjen e distributorit me prodhuesin Fabriano.

Gjithashtu si pjesë të ofertës së tij, ofertuesi detyrimisht duhet të paraqesë në SPE skedën teknike të prodhuesit ose ekuivalente.

Kjo skede duhet të jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, dhe në këtë skedë duhet detyrimisht të jene të pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike të tij për produktin leter A4.

Sa më sipër, në kemi bindjen se, ofertuesi "LIBRARI DYRRAHUT" SHPK nuk ka arritur të provojë se plotëson kriterin për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.4.4, të Shtojcës 7 të DT-së pasi për produktin leter A4, me të cilën ka ofertuar:

- Nuk ka arritur të paraqesë autorizimin e prodhuesit apo distributorit të autorizuar, pasi sikurse e shpjeguar edhe më sipër për territorin shqiptar distributor i autorizuar nga prodhuesi është vetëm shoqëria "Infosoft Office" SHPK;

- Edhe në rastin hipotetik se ka paraqitur ndonjë autorizim nga distributorë të prodhuesit që janë dhënë për shtete të tjera dhe jo për territorin shqiptar, kjo shoqëri, pra "LIBRARI DYRRAHUT" SHPK nuk ka arritur të plotësojë kërkesat e kriterit për kualifikim të përcaktuar në pikën 2.4.4, të Shtojcës 7 të DT-së , pasi nuk ka arritur të paraqesë në SPE dokumentin që verteton lidhjen e prodhuesit Fabriano me distributorin e autorizuar.

SË dyti: Nisur nga fakti se, ne i njohim shumë mire produktet e letrës së prodhuesit Fabriano SPA, jemi të bindur se kjo lloj letrë me të cilën ka ofertuar ofertuesi "LIBRARI DYRRAHUT" SHPK, nuk i plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor të përcaktuara tek specifikimet teknike në shtojcën 5 të DT-së. Pikerisht, kjo është arsyeja për të cilën edhe kompania jone, nuk ka mundur të ofertojë me këtë lloj letrë. (Fabriano Copy 1 class) Konkretisht të dhënat teknike për letren Fabriano Copy 1 class, janë si më poshtë :

Nderkohe që ne shtojcën 5 të DT-së të ndryshuar, nisur nga kërkesat për sqarim dhe rekomandimet për plotësime të specifikimeve teknike nga asistencë e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), specifikimet teknike të kërkuara për artikullin Letër A4 janë si më poshtë vijon: Format A4, "Jo me pak se 78 gr/m² sipas ISO 536" paketuar në rizma 500 flete. I risem me peshe jo me të vogël 2500 gr në peshore elektronike, Bardhësia CIE sipas ISO 11475 jo me pak se 145, me opacitet 79290 sipas ISO 2471, ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470. Trashësia 100-115 sipas ISO 534 Ashpërsia 80 — 180 ml/min sipas ISO 8791 si dhe Rezistenca në përthyerje MD (mN) >100 sipas ISO 2493 Rezistenca në përthyerje CD (mN) >45 sipas ISO 2493 (Double A ose Ekuivalent).

Letra A4 e ofertuar nga ofertuesi "LIBRARI DYRRAHUT" SHPK, e llojit "COPY 1 class" së pari: - nuk i plotëson specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në shtojcën 5 të DT-së të plotësuara: - Në skedën teknike të paraqitur nga ofertuesi "LIBRARI DYRRAHUT" SHPK, në kundërshtim me sa është kërkuar shprehimisht nga AK-ja në kriterin për kualifikim sipas pikës 2.4.4, të Shtojcës 7 të DT-së, nuk gjenden të shprehura të gjitha specifikimet teknike të produktit të letrës A4.

AK-ja e ka kërkuar skedën teknike dhe mostrën e këtij produkti me të vetmin qëllim për të krahasuar përputhshmërinë e specifikimeve të parashtruara në skedën teknike me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Në kushtet kur, në skedën teknike të produktit të letrës A4, të ofertuar nga ,, LIBRARI DYRRAHUT" SHPK nuk janë të përshkruara të gjitha të dhënat teknike të kërkuara nga AK-ja, verifikimi nëse, ky produkt, pra kjo lloj letrë i plotëson ose jo kërkesat e përcaktuara tek specifikimet teknike, bëhet i pamundur.

*Konkretisht: Në skedën teknike të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar (nëse është dorëzuar një e tillë) të letrës A4, e ofertuar nga ofertuesi “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK nuk janë, nuk gjenden specifikimet teknike të mëposhtme: 1Rezistenca në përthyerje MD (mN) “ 100 sipas ISO 2493, 2Rezistenca në përthyerje CD (mN) 7 45 sipas ISO 2493, 3*Ndriçimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470. Për më tepër që, 2(dy) nga 3(tre) parametrat e mësipërme bëjnë pjesë tek specifikimet teknike të cilat u shtuan nga autoriteti kontraktor pas shpalljes së procedurës, nisur nga kërkesat për sqarim dhe rekomandimet për plotësime të specifikimeve teknike nga asistencën e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), ndër të tjera edhe për artikullin Letër A4.*

Kjo do të thotë se këta parametra teknike të shtuar, janë cilësuar të rëndësishëm dhe detyrimisht duhet të paraqiten në skedat teknike të produkteve të ofertave, për ti bërë të mundur AK-së verifikimin e tyre.

Ky produkt gjithashtu, referuar skedës teknike të prodhuesit ose të distributorit të autorizuar (nëse është dorëzuar një e tillë) të letrës A4, nuk plotëson parametrat specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 5 të DT-së e konkretisht: 1Është kërkuar nga AK-ja: me opacitet 792.0 sipas ISO 2471. Rezulton se letra A4 e ofertuar nga “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK këtë parametër, referuar skedës teknike e ka: 9170, pra më të ulët sesa minimumi i kërkuar që duhet të jete me i madh se 9290,

Sa më sipër produkti i letrës A4 me të cilin ka ofertuar shoqëria “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, nuk i plotëson specifikimet teknike të kërkuara nga AK-ja në dokumentet e tenderit. Edhe njëherë theksojmë se është kjo arsyeja se përse shoqëria jonë edhe pse është distributore e autorizuar nga prodhuesi për territorin shqiptar nuk ka ofertuar më këtë lloj letre. Nëse do të pranohej një letër me parametrat e Fabriano Copy 1 class, natyrisht që edhe kompania jone do të kuotonte pikerisht me kete produkt dhe oferta jone do të ishte edhe me ulët, për shkak të statusit preferencial që kemi si distributor i Fabriano dhe cmimeve preferenciale me të cilat furnizohemi.

Per te plotësuar specifikimet teknike, ne kemi ofertuar me një lloj letre e cila është më cilësore dhe sigurisht që ka një cmim më të lartë se letra e ofertuar nga ofertuesi “LIBRARI DYRRAHUT” SHPK.

Me letren e ofertuar, kemi plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së për sa i përket parametrave të cilësisë, të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Theksojmë se artikulli leter A4, ze me shume se 8590 të peshes totale të ofertes, pra ky është artikulli më i rëndësishëm për AK dhe përcaktues i ofertes fituese.

KSHA marr shkas nga pretendimet e ngritura nga ana Juaj, ju drejtua zyrtarisht me email – xxxxxxxxxxxxx me qellim verifikimi dhe kerkoi informacion kush është distributori zyrtar për Letren Fabiano —Copy 1 ne Shqiperi.

Ne kthim pergjigjen e dates 19.11.2023 Fabriano konfirmon se distributor zyrtar për të gjitha brandet e letres Fabiano është Infsoft. Ne keto kushte KSHA e gjeti të sakte konstatimin tuaj dhe ka vendosur ta pranojë ankesën për kete pike. Gjithashtu pasi KSHA u konsultuam me skedën teknike të letres të paraqitur nga “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, konkludoi se nuk ka të dhena teknike të plota për specifikimet teknike, perkatesisht për :

-Rezistenca në përthyerje MD (mN) > 100 sipas ISO 2493, 2Rezistenca në përthyerje CD (mN) > 45 sipas ISO 2493: 3-Ndricimi jo me pak se 101 sipas ISO 2470.

Ne keto kushte e gjejme të drejte konstatimin tuaj dhe vendosim ta pranojë ankesën për kete pike. Referuar legjislacionit të prokurimit publik perkatesisht nenit 92 dhe nenit 82 të VKM 285, ofertuesit janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara

në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Pra sa më sipër pretendimi Juaj qëndron.

4-Përsa i përket pikes së katërt të ankimit Tuaj në të cilën pretendoni se, cit: ofertuesi “LIBRARI DYRRAHU” SHPK, nuk ka argumentuar në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP cmimet anomalisht të ulëta të ofertuara në këtë procedurë prokurimi, sqarojme se KSHA ka bere rivleresimin e argumentimit te ofertes te dorezuar me shkresen me nr. 8051 prot., date 16.10.2023 dhe ne perfundim ka arritur ne konkluzion se argumentimi i ofertes nuk eshte bere konform kerkesave te nenit 93, pasi nuk jane argumentuar te gjithe elementet e kerkuar, me konkretisht:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit,*
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhelose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës:*
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi,*
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës:*
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.*

Pra sa më sipër pretendimi i OE qëndron.

Në përfundim, për gjithcka sa trajtuam më lart, pretendimet Tuaja qëndrojnë pjesërisht ndaj ne përfundim KSHA ka vendosur ta refuzojë ofertën e paraqitur nga “Librari Dyrrahu” sh.p.k si jo të përgjegjshme.”

III.5.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.5.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

- a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*
 - i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;*
 - ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*
- b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga*

operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.5.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” nuk ka paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik argumente në cilësinë e subjektit të interesuar në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe për këtë fakt bazuar në nenin 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen për ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK.

III.5.5. Sa më sipër, në kushtet kur autoriteti kontraktor ka pranuar një pjesë të pretendimeve të palës ankimuese, KPP gjykon, se pretendimet e tjera nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2018, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga ankimuesi “Interlogistic” SHPK për operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari për nevojat e OSHEE Group Sh.A, OSSH Sh.A, FSHU Sh.A, FTL Sh.A, për një vit”, me fond limit 59,032,679.90 lekë (pa TVSh), zhvilluar më datë 29.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.

2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga ankimuesi “Interlogistic” SHPK për operatorin ekonomik “Infosoft Office” SHPK, për procedurën e sipërcituar të prokurimit.
 3. Autoriteti Kontraktor të skualifikojë operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, sipas vendimmarjes së tij dërguar në KPP me shkresën nr. 6413/16 prot., datë 23.11.2023, protokolluar me tonën me nr. 2750/3 prot., datë 30.11.2023.
 4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik.
 5. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga ankimuesi “Infosoft Office” SHPK, për operatorin ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK, për procedurën e sipërcituar të prokurimit.
 6. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
 7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Interlogistic” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK.
 8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar
Fiorent Zguro	Kreshnik Ternova	Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

